



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:132390

Datë: 20.06.2022

Numri i dokumentit: 03148763

PS.nr.1 /22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI SPECIAL, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja Violeta Namani-Hajra-kryetare e trupit gjykues, gjyqtarët Lutfi Shala dhe Mentor Bajraktari si anëtarë të trupit gjykues, me bashkëpunëtorin profesionale Driton Berisha, në çështjen penale kundër të pandehurve M.B dhe SH.B, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, me numër PPS.nr.73/2021, të datës 13.01.2022, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të datës 01.06.2022, në prezencën e Prokurores së Prokurorisë Speciale Florije Shamolli, të pandehurve M.B me av. Agnez Furra dhe SH.B me av.Elena Dragusha gjykata me datë 06.06.2022, mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me datë 17.06.2022, e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

1.M.B i lindur me, në, Republika e Turqisë, nga i ati dhe e ëma, me vendbanim, i martuar, prind i një fëmije, ka të kryer shollën e lartë-bachelor, me profesion tregtar, i gjendjes së mesme ekonomike, shtetas i Republikës së Turqisë, me numër të letërnjoftimit, gjendet në masë të paraburgimit nga data 23.06.2021.

2.SH.B, i lindur me në-Turqi, nga i ati dhe e ëma, e gjinisë, me vendbanim në rruga “.....”, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion shofer i autobusit, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër të letërnjoftimit, gjendet në masë të paraburgimit nga data 19.07.2021.

Konfrom nenit 365 par.1 të KPPRK-së,

JANË FAJTOR

Më datë 23.06.2021, në Prizren, rreth orës 08:10, saktësisht në parkingun e pompës së derivateve “Shell”, e cila gjendet në daljen veriore të autostradës “Ibrahim Rugova”, duke vepruar në bashkëveprim dhe pas një koordinimi paraprak në mes vete, me dashje dhe duke e ditur se parat janë të falsifikuara, me qëllim të vënies në qarkullim të parasë së falsifikuar si para e vërtetë, për përfitim të kundërligjshëm të dobisë pasurore, fillimisht i pandehuri SH.B, duke shfrytëzuar autobusin e udhëtarëve të kompanisë “Alpar” të cilin e voziste vetë në relacionin Stamboll -

Shkup- Prizren dhe anasjelltas, nga Turqia ka sjellë në Stacionin e Autobusëve në Prizren, para të falsifikuar dhe atë: bankënota në vlerë 40,000 (dyzetmijë) dollarë amerikan dhe 1,500 (njëmijë e pesëqind) Euro, (320 bankënota me prerje nga 100 dollarë, 160 me prerje nga 50 dollarë amerikan dhe 3 bankënota me prerje nga 500 Euro), ashtu qe: i pandehuri SH.B ditën kritike me të arritur në Prizren, me telefon mobil e thërret punëtorin e kompanisë “Alpar” M.SH që të shkoj dhe të takohen, pastaj M.SH me veturën e tij të tipit “Range Rover” ngjyrë e bardhë, me targa: 04-788-HT, ka shkuar dhe janë takuar me SH.B në një lokal, duke qëndruar një kohë të shkurtër ku SH.B i ka kërkuar M.SH që ta dërgoj deri në parkingun e pompës së derivateve “Shell”, pasi që ishte me veturë, duke i thënë se ka për tu takuar me një person dhe M.SH ka pranuar, pastaj e ka dërguar dhe me të arritur tek pompa e derivateve, M.SH hyn në një market, ndërsa i pandehuri SH.B shkon tek i pandehuri M.B i cili ishte në pritje të dërgesës me veturën “Ford Focus” ngjyrë e bardhë, me targa maqedonase: SK-0083-A, i shoqëruar nga shoferi i tij F.K, dhe ja dorëzon një qese të zeze me paratë e falsifikuara të sjellura nga Republika e Turqisë, me qëllimin përfundimtar që ato të investohen nga të pandehurit në ndonjë aktivitet biznesi, duke i paraqitur në qarkullimin juridik në Kosovë si para të vërteta,

- Me këtë të pandehurit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale: Falsifikim i parasë nga neni 296 par.2 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 7,17, 38, 39,40, 42,69, 79, 296 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe nenit 365, 367, 450, 453 të KPPRK-së, të pandehurit i:

G J Y K O N

Të pandehurin M.B, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim që nga data 23.06.2021, deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë, i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurin SH.B, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e katër (4)muaj, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim që nga data 19.07.2021, deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë, i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurve SH.B dhe M.B në bazë të neneve 367, par.1, nen par 1.1 të KPPRK-së, ju vazhdohet masa e paraburgimit derisa aktgjykim i merr formë të prerë, por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar në aktgjykim.

Obligohen të pandehurit SH.B dhe M.B se cili veç e veç ti paguaj të gjitha shpenzimet procedurale gjyqësore, në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 100 € (dyqind euro), si dhe shumën prej pesëdhjetë (50) €, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konfiskohet vlera e parave prej 40,000 (dyzetmijë) dollarë amerikan dhe 1,500 (njëmijë e pesëqind) Euro, si dhe telefoni i markës “Huawei” pronë e të pandehurit M.B.

ARSYETIMI

Prokuroria Speciale të Republikës së Kosovës pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzë PPS.nr.73/2021, të datës 13.01.2022, kundër të pandehurve M.B dhe SH.B, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata, në kuptim të nenit 246 par.1 të KPPK-së, në seancën e shqyrtimit fillestar i mbajtur me datë 22.02.2022, i ka udhëzuar të akuzuarit për të drejtat e tyre ligjore dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit Special, i ka udhëzuar të njëjtit në vështirimit të nenit 248, mbi të drejtën e deklarimit ose jo të pranimit të fajësisë. Të pandehurit M.B dhe SH.B, se cili veç e veç kanë deklaruar se aktakuzën e kanë kuptuar në tërësi, dhe e kanë mohuar fajësinë për kryerjen e veprës penale që i ngarkon kjo aktakuzë.

Gjykata, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit të dytë më datë 25.03.2022, për elaborimin e kërkesave për hedheje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave të paraqitura nga mbrojtja e të pandehurve M.B dhe SH.B ku është marr edhe përgjigja e Prokurores së Prokurorisë Speciale.

Më datë 28.03.2022, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, mori Aktvendimin PS.nr.1/2022, me të cilin refuzoi si të pabazuar Kërkesat për hedhje të Aktakuzës dhe Kundërshtimin ndaj Provave, të parashtruar nga Mbrojtësit e të pandehurve M.B dhe SH.B.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor me date 30.05.2022, ku palët heqin dorë për leximin e aktakuzës nga prokurorja e Prokurori Speciale, i pandehuri M.B ka deklaruar se aktakuzën e ka kuptuar në tërësi, dhe e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale që i ngarkon kjo aktakuzë, ndërsa i pandehuri SH.B ka deklaruar se aktakuzën e ka kuptuar në tërësi, dhe e ka mohuar fajësinë për kryerjen e veprës penale që e ngarkon kjo aktakuzë.

Gjykata, duke qenë se nuk e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri M.B, nga arsyeja se të njëjtit akuzohen se veprën e kanë kryer në bashkëkryerje, dhe nuk mund të aprovohet pranimi i fajësisë vetëm i njërit përtej tyre dhe duke qenë se i akuzuari SH.B nuk e ka pranuar fajësinë, konform nenit 327 të KPPRK-së, gjykata ka kaluar në radhën e paraqitjes së provave dhe fjalën përfundimtare të palëve në procedurë.

Prokurorja e Prokurori Speciale në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e prezantuara në shqyrtimet kryesore duke u nisur nga raporti i bastisjes i datës 23.06.2021, i cili raport është bërë në pompën e derivate “Shell” në Prizren, gjithashtu nga foto albumi i vendit të ngjarjes i datës 23.06.2021, nga videoinxhizimet e datës 23.06.2021, të marra nga pompa e derivateve “Shell” në Prizren si dhe nga raporti i ekspertimit të parave të datës 09.07.2021, me të cilin raport është konstatuar se paratë në vlerë prej 40.000 dollarëve si dhe 1.500 euro janë të falsifikuara e i cili raport mbështetet me deklaratat e dëshmitarëve të dëgjuar si F.K i cili deklaroj se është njohur me të akuzuarin M.B dhe se për paratë të cilat kanë pas të vijnë nga Turqia në Kosovë i akuzuari M.B e ka ditur se këto para janë të falsifikuara e cila deklaratë mbështet edhe në deklarinimin e të akuzuarit M.B i cili pranoi se këto para kanë ardh nga Republika e Turqisë për në Kosovë e të cilat i ka para i ka sjellë i pandehuri SH.B në mënyrë të qartë vërtetohet se dy të akuzuarit kanë kryer veprën penale Falsifikim i parasë në bashkëkryerje nga neni 296 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa mbrojtja e të akuzuarit SH.B se nuk e ka ditur se këto para janë të falsifikuara është vetëm sa për t’iu shmangur përgjegjësisë penale pasi që vet i njëjti deklaroi që si shofer i autobusit 11 vite ka kryet këtë punë dhe ai më së miri e din se paratë duhet të deklarohen në kufi deri në shumën prej 10,000 euro dhe kjo është vetëm për t’iu shmangur përgjegjësisë penale, po ashtu shumë mirë e din që ekzistojnë bankat në të gjitha shtetet dhe ato para mund të vijnë përmes bankave të ndryshme e jo ti sjellin me qese në Kosovë, nëse bëjmë

një analizë të video inxhizimeve të marra në pompën “Shell” në Prizren, shihet se si i akuzuari SH.B vjen me veturën e markës “Range Rover”, pronë e M.SH dhe sikur të kishte qenë i sigurt që këto para janë në rregull mendoj që personi që i ka kërkuar M.B do ta priste në stacion të autobusëve dhe jo i njëjti ta thirr personin vet dhe ti dërgoj në një destinacion siç është pompa “Shell”, andaj mbi bazën e të gjitha këtyre duke u nisur nga dëshmia e dëshmitarit F.K, pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuari M.B dhe provave dhe rrethanave të lartcekura i propozoj gjykatës që të njëjtit ti shpall fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit, ndërsa paratë e falsifikuara të konfiskohen.

Mbrojtësi i të pandehurit M.B, av. Agnez Furra në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar, e po ashtu të elaboruar shkurtimisht me gojë, ka theksuar se i mbrojturi im, gjatë gjithë fazave të procedurës penale ka bashkëpunuar me organet e ndjekjes, e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, anipse gjykata nuk e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e tij, mirëpo që sido qe të jetë, duke pasur parasysh numrin e pak të provave, ky pranim ka qenë shumë i rëndësishëm në vërtetimin e gjendjes faktike, prandaj, duhet të vlerësohet si rrethanë veçanërisht lehtësues, dhe me këtë rast të zbatohet dispozitat për zbutjen e dënimit nën minimumin e parashikuar me ligj. Po ashtu ka shtuar që si rrethana lehtësues të merret fakti që i njëjti nuk është shtetas i Republikës së Kosovës, se familjen e ka larg dhe ka vështirësi në komunikim, se pranimin e fajësisë e ka bërë i penduar thellësisht dhe duke premtuar se në të ardhmen nuk do të bije ndesh me ligjin. Andaj, në kushtet e ekzistimit të gjithë këtyre rrethanave, ka kërkuar që të njëjta të merren parasysh dhe të vlerësohen me rastin e shqiptimit të dënimit.

I pandehuri M.B në mbrojtjen e paraqitur gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se e datë 19 apo 20 qershor të vitit 2021, ka ardhur në Kosovë për tu takuar me një klient për tekstil me emrin I.H të cilin e ka gjetur F.K, ka zbritur në Shkup, e ka marr një veturë me qira, dhe s’bashku me F.K kanë shkuar në fabrikën e Isës e cila gjendej në magjistralen për Vushtrri me emrin “Beta Tekstil”, rrethanë kjo që mund të vërtetohet nga komunikimet në “whats-app” lidhur me ofertat dhe propozimet për tekstil. Më tutje ka shtuar se gjatë kohës duke qëndruar me F.K, ka pas një thirrje telefonike nëpërmjet “whats-app” me kamerë prej Stambollit me personin me emrin A.B, i ka treguar parat në kamerë dhe ka kërkuar prej tij ta ndihmoj që paratë – dollarët të sjellën në Kosovë, telefonon e ka marr F.K dhe ka vazhduar të flas me të për këtë çështje dhe janë marr vesh, pastaj i akuzuari M.B e ka thirrur Agjensionin “Alpar” i ka pyetur ata se kush është shofer për atë ditë, ata më njoftuan se atë ditë është shoferi SH.B, duke e njohur nuk e kanë pyetur për çfarë arsye po pyet kush është shofer, pastaj Ali Bashak i ka dërguar paratë në Agjensionin “Alpar”, aty ja ka dhënë SH.Bit në qytetin e Stambollit, SH.Bit përmes telefonit e ka njoftuar se ato janë para, por SH.Bi nuk e ka ditë që paratë janë të falsifikuara, andaj me datë 23.06.2021, me veturën “Ford Focus” ngjyrë e bardhë, me targa maqedonase: SK-0083-A, i shoqëruar nga shoferi i tij F.K, kanë shkuar te “Shell Petroll” në Prizren, ku i ka marr nga SH.Bi paratë, të njëjtat para kanë qenë të vendosura në një qese të zezë, meqenëse se F.Ku këtë vlerë të parave e ngriti në 40.000 dollar atëherë ndrysho edhe vlera e përqindjes që do ta merr personi i cili do ti sjell paratë në Kosovës dhe për këtë është dashur të paguhet 400 euro SH.Bit, por atë dit nuk i kamë dhënë para SH.Bit ti kamë thënë ti dha ma vonë. Po ashtu edhe në marrjen në pyetje në Polici me datë 23.06.2021, dhe marrjes së deklaratës në Prokurori me datë 26.10.2021, ngjashëm ka deklaruar, lidhur me rrethanat për të cilat është pyetur. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e përkrah në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, duke shtuar se në aktakuzë thuhet se akuzohet për qëllim të futjes së parave në qarkullim në treg, në lidhje me këtë nuk ka asnjë dëshmi në shkresat e lëndës, andaj kërkon nga gjykata që ti merr parasysh këto rrethana me rastin e marrjes së vendimit, se në video-incizime nuk ekziston video ku shihet që është duke ja dhënë paratë F.Kut, por shton se unë i beson drejtësisë së Kosovës.

Mbrojtësja e të pandehurit SH.B av. Elena Dragusha në fjalën përfundimtare të përgatitur në formë të shkruar, ka theksuar se nga të gjitha provat e administruara, nuk është vërtetuar se i mbrojturi i saj, ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, pasi që prokuroria nuk ka mundur ta arsyetoj kualifikimin për veprën penale për të cilën akuzohet i akuzuari SH.B për shkak se nuk janë përmbushur elementet e figurës së kësaj vepre penale siç janë, dijenia se paratë kanë qenë të falsifikuara, dashja e kryerjes së veprës penale, përfitimi material nga kryerja e kësaj vepre penale, vurja në qarkullim e parasë, kjo vërtetohet me dëshmitë e dëshmitarëve F.K, I.M dhe E.SH, ku është vërtetuar se i akuzuari SH.B, nuk e ka ditur se ka qenë duke transportuar para false, se i njëjti është djalë i mirë, i sjellshëm dhe i respektueshëm nga të tjerët, çka përjashton çfarëdo mundësie që i njëjti të jetë, i përfshirë në çfarëdo aktivitet kriminal. Po ashtu ka shtuar se edhe vet i bashkakuzuari M.B ka dëshmuar faktin se i mbrojturi i saj nuk ka qenë në dijeni se paratë është dashur të i dërgoj nga Turqia në Kosovë, kanë qenë të falsifikuara, se ka qenë një rastësi që me rastin e kontaktimit të Agjensionit “Alpar”, si shofer për atë ditë ka rastisur të jetë tani i akuzuari SH.B, dhe që sigurisht as vetë i akuzuari SH.B dhe as agjensioni nuk është njoftuar, se kemi të bëjmë me para të falsifikuara. Po ashtu ka shtuar se edhe vetë i akuzuari SH.B, në mënyrë të drejtë dhe të sinqertë i ka shpjeguar veprimet e tij, pra se nuk e ka ditë se paratë janë të falsifikuara, se siç e ka pohuar edhe i bashkakuzuari M.B, transporti është kryer me kompensimin e një shumë të parave, e cila ka qenë e vogël, përkatësisht po të dinte se kemi të bëjmë me para të falsifikuara, duke marr parasysht rrezikun, do të kërkonte, sigurisht një shumë më të madhe. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të mbrojturin e tij, në mungesë të provave ta liroj nga akuzua, lidhur me veprën penale për të cilën është akuzuar.

I pandehuri SH.B në mbrojtjen e paraqitur gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se i bashkakuzuari M.B e ka thirr në telefon në ditën kur jeni nisur nga Stambolli rreth orës 15:30, duke i thënë se është në Kosovë për me hap një firmë, dua me i ble do makina të tekstilit, fillimisht i ka thënë se duhet të ja sjell 20.000 dollar, e pastaj 40.000 dollar, dhe pastaj, tek i akuzuari ka shkruar një person i cili i ka thanë se është dërguar nga M.Bi për dorëzimin e shumës së parave për të cilat kishte folur me M.Bin, i ka marr paratë dhe i ka vendosur në çantën e tij, dhe çantën e ka vendosur në bagazh të autobusit, dhe është nisur për në Kosovë, e ka vozitur autobusin deri në hyrje në Maqedoni, pastaj, autobusin e ka vozitur shoferi tjetër, derisa që vetë ka fjetur deri në Ferizaj, kur edhe ka kontaktuar me M.Bin, me të cilin janë pajtuar që të takohen në Prizren, mirëpo që janë takuar në përfundim të autostradës të pompa e derivateteve “Shell”, ja ka dorëzuar paratë, ndërsa që shumën prej 400 euro në emër të kompensimit për transport, janë pajtuar që të ja paguar më vonë. Më tutje ka shtuar se po të dinte se paratë janë të falsifikuara, nuk do rrezikonte me i kaluar 6 kufijtë për me e rreziku veten dhe udhëtarët, se në të gjitha pikat kufitare i ka deklaruar paratë, ju ka thënë se janë 4 persona dhe i ke 40.000 dollarë me veti, i ka shikuar oficerët doganorë paret dhe kanë thënë gjithçka në rregull, shoferët tjerë nuk kanë qenë në dijeni për paratë, dokumente nuk ka për këto deklarime, ndërsa që kur kanë hyrë në Kosovë ka qenë fjetur dhe për këtë nuk i ka deklaruar. Më tutje ka shtuar se edhe herave tjera ka transportuar shuma të parave, në sasi më vogla, dhe se pikërisht duke qenë në tërësi pafajshëm, posa ka pasur mundësi, pas ftesës nga Policia, është paraqitur për ta njoftuar prokurorin se nuk kam asgjë lidhje me këtë punë. Edhe në deklaratën e dhënë në procedurën paraprake, përkatësisht në deklaratën e dhënë në Prokurori me datë 19.07.2021, ngjashëm ka deklaruar lidhur me rrethanat për të cilat është pyetur. Ndërsa që në fjalën ka deklaruar se e përkrahu në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtëses së tij dhe nuk ka çka të shtoj diç tjetër.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka proceduar dhe administruar të gjitha provat e propozuara nga Prokuroria dhe mbrojtja dhe atë: ka dëgjuar në cilësinë dëshmitarëve: F.K, E.SH dhe I.M, në cilësinë e provave materiale janë administruar: Raporti i bastisjes i datës 23.06.2021, në të cilin raport është rasti i cili ka ndodh në pompën e derivateve “Shell”, në Prizren; foto

albumi i vendit të ngjarjes i datës 23.06.2021; Video incizimi i datës 23.06.202, marra në pompën e derivateve “Shell” në Prizren; Raporti i ekspertimit të pajisjeve elektronike të datës 16.08.2021; Raporti i ekspertimit të parave të datës 09.07.2021.

Dëshmitari F.K, në dëshminë e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se i njehë që të dy të akuzuarit, të akuzuarin M.B e ka njehur dhe është takuar për here të parë me të 1 muaj para se të ndodh rasti, derisa ka qenë duke udhëtuar me aeroplan, me të njëjtin ka biseduar rreth punës dhe tregtisë me tekstil, nga shteti i Turqisë me pru në Kosovë, dhe janë pajtuar që të takohen në Kosovë, ndërsa që të akuzuarin SH.B, e njehë ngase ka udhëtuar me firmën e autobusëve në të cilën i njëjti ka qenë shofer i autobusit, mbikëqyrës ose punëtor. Më tutje ka shtuar se ditën kur është ndalur nga policia pra me datë 23.06.2021, rreth orës ora 07 e 30 afërsisht në mëngjes është nisur nga shtëpia e tij në Vushtrri dhe ka shkuar për ta marr M.Bin i cili ka qenë duke qëndruar në një hotel në Shupkofc përball Pallacit, pasi që s’bashku kanë pasur të shkojnë në Prizren, në stacion të autobusit, për ti marr disa copa të tekstitit për mostra, që siç i ka thënë M.B vjen një person për të ja sjellë, mirëpo emrin nuk ja ka përmendur dhe për këtë dëshmitari është paguar me shumën 60 apo 100 euro nga M.Bi. Ka theksuar se gjatë udhëtimit M.Bi ka biseduar por nuk e din me kënd ka biseduar, pasi që biseda ishte në gjuhën turke, pastaj, në rrugëtim e sipër i është thënë se takimi do realizohet në mes të dy “Hib petrol”, që gjenden para se me hy në hyrje të Prizrenit, ku edhe janë ndalur, M.B ka shkuar tualet, ndërsa që dëshmitari ka qëndruar jashtë veture, pastaj ka ardhur një veturë e markës “Range”, i bardh, e ka vërejtur një person qe ka dal nga vetura, ka arritur ta shohë vetëm nga mbrapa ka pas këmishë të bardhë vesh, i është ofruar M.Bit, dhe pas ndarjes me të njëjtin, M.Bi është kthyer në veturë me një kесе të zezë apo ngjyrë kafe, ngjyrë e mbyllur e madhësisë normale (30 -30cm), dhe nuk kanë kaluar 2 minuta, kur janë ndalur nga Policia. Po ashtu ka shtuar sa i përket të akuzuarit SH.B, është i bindur 100% se i njëjti nuk e ka ditur se nuk e kish bo at punë me marr pare fallcë, se edhe vetë vonë pasi që ka ndodh rasti e ka kuptuar që ka pas pare fallcë në atë qese.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, të cilën dëshmi e ka gjetur të singertë dhe objektive, e nga e cila ka vërtetuar faktin se ka qenë i akuzuari M.B i cili e ka angazhuar që ta dërgoj deri në Prizren, që siç i ka thënë për të marr një copë të tekstitit për mostër, pastaj i njëjti është ka kërkuar të ndalet tek pompa e derivateve të cilën dëshmitari gabimisht e ka përmendur “Hib petrol”, e që në të vërtetë siç është vërtetuare dhe nga provat tjera materiale janë ndalur te pompa e derivateve “Shell”, dhe se i akuzuari M.B ka pranuar një qese të zeze, të mbushur, dhe me të njëjtën është futurë në veturë, siç është vërtetuar tanimë në brendinë e të njëjtës ka pasur kartëmonedha në dollar të falsifikuara. Kjo dëshmi e këtij dëshmitari është në përputhje edhe me provat tjera materiale, siç janë Raporti i bastisjes i datës 23.06.2021, se veturës në të cilën edhe janë gjetur parat e falsifikuara, pastaj edhe Video incizimi i datës 23.06.202, marra në pompën e derivateve “Shell” në Prizren, në të cilin shihet vetura “Ford Focus” me tabele të Shkupit, e pranishme në ato ambiente, si dhe hyrja e veturës “Range Rover” me ngjyrë të bardhë, të cilën ka qenë i akuzuari SH.B, i cili edhe ja ka dorëzuar parat tani të akuzuarit M.B, e po ashtu kjo dëshmi është në përputhje edhe me vete pohimet e të akuzuarve M.B e SH.B, të cilën e kanë pranuar faktin se janë takuar pikërisht në at vend, ku edhe është dorëzim pranimi i parave të falsifikuara. Ndërsa që sa i përket bindjes së tij, mbi mos dijeninë e të akuzuarit SH.B, gjykata vlerëson se në këtë rast kemi të bëjmë me një vlerësim të dëshmitarit, bindje kjo që lidhet me raportin që ka me këtë të akuzuar, e që mund të vazhdoj të mbaj këtë bindje, mirëpo që bindjet nuk mund të përdoren si mjete prove, pasi që janë qëndrime subjektive lidhur me njerëzit dhe ngjarjet e caktuara, dhe se kjo nuk e dëmton dëshminë e këtij dëshmitari në besueshmërinë e saj, meqenëse dëshmia e tij lidhet me atë që ka parë e dëgjuar, dhe jo për vlerësime subjektive, që janë krejt jo relevante.

Dëshmitari E.SH, në dëshminë e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se me datë 23.06.2021, në ora 17:00 është nisur nga Stambolli, ndërsa që në ora 06:00 të mëngjesit të ditës së nesërme kanë arritur në Prizren, se edhe gjatë këtij udhëtimi e ka parë të akuzuarin SH.B, të cilin e njehë si shofer qe 5 vite, ka pas sjellje të njëjta si gjithherë, bashkë kanë konsumuar cigare e kafe dhe se i njëjti ka vozitur nga “Kapokulës” deri në “Kriva-Pallankë” në hyrje të Maqedonisë, dhe pasi e kanë kaluar Maqedoninë, SH.Bi si çdo shofer tjetër ka shkuar me fjet, dhe se në ulësen të cilën ka qenë ulur me numër 38-39, ka mundur të shohë momentin kur është bërë ndërrimi i shoferëve, por edhe din nga udhëtimet e shpeshta, që shoferi shkon me fjet. Po ashtu ka shtuar se beson që SH.Bi me vetëdije nuk e ka bërë atë punë për të cilën akuzohet, pasi që i gjithë Prizreni e respekton si njeri të mirë, gjatë udhëtimeve të shpeshta, kur SH.Bi ka qenë shofer, ka kaluar shumë mirë dhe nuk ka pasur asnjë telashe, se shumë e donë SH.Bin, e po ashtu edhe policia dhe doganierët në kufij e kanë respektuar SH.Bin.

Dëshmitari I.M, në dëshminë e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar të akuzuarin SH.Bin e njeh vetëm si shofer të kompanisë “Alfa Turizën” me seli në Stamboll dhe se me datën 23.06.2021, ka udhëtuar për në Kosovë, me c’rast SH.Bi ka vozit prej hyrjes në Bulgari deri në Kriva Pallankë, në dalje të kufirit me Maqedoni, pastaj SH.Bi ka hyrë në pjesën e autobusit ku është i vendosur shtrati për fjetje dhe deri në Ferizaj ku ka zbritur dëshmitari, SH.Bi ka qenë duke fjetur. Me tutje ka shtuar se si në çdo rast tjetër edhe gjatë këtij udhëtimi, janë ndalur për kontroll në pikat kufitare, dhe se zakonisht bëhen kontrole dhe ju merren pasaportat udhëtareve, ka raste kur polici hyn brenda në autobus dhe ka raste kur udhëtarët zbresin prej autobusit dhe shkojnë te sporteli ku bëhet kontrollimi i pasaportave, në ditën kritike kanë dal nga autobusi, ndërsa që dogana e kanë kontrolluar bagazhin e autobusit dhe nuk kanë gjete asgjë.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshmitë e këtyre dy dëshmitareve të propozuara nga mbrojtja, dëshmitarëve E.SH dhe I.M, mirëpo këto dëshmi i ka gjetur si dëshmi jo të sinqerta, dhe jo objektive, e që të njëjta janë dëshmi të përpunuara dhe në funksion të lehtësimit të pozitës penale për të akuzuarin SH.B, pasi që të dy këta dëshmitar, në dëshminë e tyre janë fokusuar tek pohimi i rrethanës se tani i akuzuari SH.B, me rastin e kalimit të pikës kufitare për të hyr në Kosovë, ka qenë fjetur, dhe se kjo për të vërtetuar alibin e të akuzuarit SH.B, se kinse arsyeja e mos deklarimit të shumës së parave, ka qenë pikërisht qenia e ti duke fjetur, mirëpo tanimë i akuzuari SH.B, tërthorazi e ka pranuar faktin se parat nuk i ka deklaruar edhe gjatë, kalimit nëpër pikat kufitare të shteteve tjera, përkatësisht në shtetin e Bullgarisë dhe shtetin e Maqedonasi, anipse sipas tij nuk është përpiluar dokumentacion me rastin e deklarimit, rrethanë kjo e pamundshme, duke pasur parasysh se në gjithë secilin rast, është fakt notor që gjatë deklarimit bëhet evidentimi dhe regjistrimi, i gjësendeve të deklaruara. Pra është e qartë, se dëshmitë e këtyre dy dëshmitarëve sa i përket rrethanave objektive për të cilat kanë deklaruar, janë pozitivisht e rrejshme, e kjo vërehet dhe nga mënyra e sforcuar e përshkrimit të personalitete të tij, si djalë i mirë, që e dojnë dhe e respektojnë të gjithë, anipse sa i përket perceptimeve dhe vlerësimeve subjektive të tyre lidhur me personalitetin e të akuzuarit SH.B, gjykata vlerëson se kjo është e drejtë dhe vlerësim i tyre, por që nuk janë ftuar të deklarohen për bindjen e vlerësimeve të tyre, pasi që këto janë krejt jo relevante, për gjithë secilën çështje penale, përfshirë dhe këtë çështje penale.

Nga raporti i bastisjes me datë 23.06.2021, në parkingun e pompës së derivateve “Shell Petroll” në Prizren, ku nga Policia është ndalur vetura në të cilën ka qenë i pandehuri M.B dhe në atë veturë janë gjetur parat e falsifikuara, të cilat janë sekuestruar dhe është arrestuar i pandehuri M.B.

Nga foto albumi i vendit të ngjarjes së datës 23.06.2021, vërtetohet se në të njëjtin përmes fotografive është paraqitur vendi i ngjarjes, përkatësisht vetura ngjyrë e bardh me targa të Republikës së Maqedonisë së Veriut SK-0083 AJ, e cila ka qenë e ndaluar në parkingun e pompës së derivateve “Shell Petroll” afër hyrjes-daljes së autostradës Veri-Prizren (fotot:1-6), pastaj brendia e automjetit ku edhe janë gjetur shuma e parave në valut amerikane, në brendi të një qese të zezë, e cila ka qenë e vendosur në karriken e parë të automjetet (fotot:7-16), si dhe kartëmonedhat e gjetura përfshirë numrat serik të tyre (fotot 26-88).

Nga video incizimet e kamerave të sigurisë e datë 23.06.2021, të marra nga kompania e derivateve Shell, shihet se në parkingun e “Shell Petroll” rreth orës 08:04 ka hyrë vetura “Range Rover” me ngjyrë të bardhë (kjo shihet në kamerën me numër 9), kurse rreth orës 08:08 shihet duke tentuar të dalë vetura “Ford Focus” me tabele të Shkupit, e cila është ndaluar nga policia dhe është arrestuar i pandehuri M.B dhe është sekuestruar qesja e zezë me parat e falsifikuara (shihet në e kamerës me numër 10).

Nga Raporti i ekspertimit nga AKF, i datës 19.07.2021, janë ekzaminuar bankënota në vlerë 40,000 (dyzetmijë) dollarë amerikan (320 bankënota me prerje nga 100 dollarë, 160 me prerje nga 50 dollarë amerikan dhe 1,500 Euro (3 bankënota me prerje nga 500 Euro) të cilat kanë rezultuar se janë të falsifikuara.

Gjykata ka vlerësuar raporti i bastisjes me datë 23.06.2021, në parkingun e pompës së derivateve “Shell” në Prizren, foto albumin e vendit të ngjarjes së datës 23.06.2021, video incizimet e kamerave të sigurisë e datë 23.06.2021, të marra nga kompania e derivateve “ Shell Petroll”, Raporti i ekspertimit nga AKF, i datës 19.07.2021, e nga të cilat ka vërtetuar, bindshëm faktin që shumën e parave, tani i akuzuari M.B e ka pranuar nga tani i akuzuari SH.B, pasi që të njëjtit janë takuar, në parkingun e pompës së derivateve “Shell Petroll”, ashtu siç kanë qenë të dakorduar paraprakisht, dhe se kjo shumë e parave në kartëmonedha dollar amerikan, është gjetur në veturën të cilën tani i akuzuari M.B e kishte marr me qira, ndërsa që e njëjta ka rezultuar të jetë e falsifikuar. Këto prova janë në përputhje edhe me vetë deklaratimet e të akuzuarave M.B dhe SH.B, të cilët kanë pranuar faktin se ditën kritike janë takuar, se është bërë dorëzim pranimit i parave, të cilat edhe janë sekuestruar nga organet e ndjekjes, dhe se siç e ka pohuar i akuzuari M.B të njëjta kanë qenë të falsifikuara, ndërkaq që po ashtu edhe dëshmitari F.K e ka pohuar faktin se ka parë një person i cili ja ka dorëzuar qesen ngjyrë të zezë tani të akuzuarit M.B dhe se i njëjti më pastaj, ka hyrë në veturë, në brendi të cilës edhe janë gjetur të njëjtat. Pra, marr në tërësi, rrethanat e vërtetuara përmes këtyre provave nuk janë kontestuar as nga vetë të akuzuarit M.B dhe SH.B, qoftë sa i përket takimi të tyre, dorëzimit të parave, pasi që të njëjtat i kishte transportuar nga Republika e Turqisë për në Republikën e Kosovës.

Nga Raporti i ekspertimit të Pajisjeve elektronike të datës 16.08.2021, me numër të Ref: AKF-2021-0224, konkretisht ekzaminimi i telefonit “Huawei”, të sekuestruar nga i pandehuri M.B, shihet se i pandehuri M.B ka komunikuar vazhdimisht me të pandehurin SH.B, si dhe me persona tjerë të pa identifikuar në Republikën Turke. Gjykata ka vlerësuar edhe këtë provë materiale, e nga e cila ka vërtetuar faktin se tani të akuzuarit M.B dhe SH.B, gjatë gjithë rrugëtimit të sjelljes së parave në Kosovë nga i akuzuari SH.B, kanë qenë në kontakte të vazhdueshme, në mes vete, çka vërtetona faktin se tani i akuzuari SH.B ka qenë në dijeni se shuma e parave e transportuara nga Republika e Turqisë për në Republikën e Kosovës, është e falsifikuar, dhe se pikërisht duke pasur parasysh rrezikun e vazhdueshme gjatë rrugëtimit për sjelljen e tyre në Kosovë, mundësin për gjetjen e tyre nga organet ligjzbatuese të shteteve në për të cilat është realizuar transportimit, në vazhdimësi ka mbajtur kontakte më ta pandehurit M.B, për ta siguruar se nuk janë paraqitur probleme, e që ky interesim i të pandehurit M.B, shpjegohet jo vetëm me veprimet e ndaluar në të

cilin është përfshirë dhe rrezikun në rast të identifikimit, mirëpo edhe sasinë e parave, të falsifikuara të investuar për të u hedhur në qarkullim si para të vërteta.

Vlerësimi ligjor

Gjykata vlerëson se pas procedimit të të gjitha provave personale dhe materiale e të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, të vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, gjykata vërtetoi gjendjen faktike të precizuar si të dispozivin e këtij aktgjykimi, ashtu që bazuar në një gjendje të tillë faktike, të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë lidhur me këtë çështje penale, kjo gjykatë vlerëson se në veprimet e të akuzuarve M.B dhe SH.B, manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale, Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK.

Gjykata vëren se për tu gjendur në kushtet e kryerjes së veprës penale Falsifikim i parasë sipas dispozitave ligjore të nenit 296 par.2 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, është e nevojshme të vërtetohet ekzistimi i prodhimit, ndryshimi ose vënia e parasë së falsifikuar në qarkullim, ndërsa venja në qarkullim si rrethanë cilësuese e kësaj vepre penale është parashikuar se ekziston kur në person kryen së paku njëri nga veprimet alternative dhe atë duke marr (furnizohet) me para të falsifikuara, pastaj vën në qarkullim paranë e falsifikuar; transporton para të falsifikuar; përdor para të falsifikuar, apo kur posedon para të falsifikuar me qëllim që të vihen në qarkullim si e vërtetë. Në rastin konkret lidhur me të akuzuarit M.B dhe SH.Bi, jemi në kushtet e kryerjes së kësaj vepre penale në atë mënyrë që duke vepruar në bashkëveprim dhe pas një koordinimi paraprak në mes vete, me dashje dhe duke e ditur se parat janë të falsifikuara, kanë pasur për qëllim të vënies në qarkullim të parasë së falsifikuar si para e vërtetë, për përfitim të kundërligjshëm të dobisë pasurore, ashtu që kanë organizuar transportimin e tyre nga Republika e Turqisë për në Republikën e Kosovës duke shfrytëzuar autobusin e udhëtarëve të kompanisë “Alpar”, në të cilin i akuzuari SH.B ka qenë vozitës, dhe pastaj pasi që i njëjti i ka sjell në Kosovë, i’a ka dorëzuar të akuzuarit M.B në vendin, kohen dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv, me qëllimin përfundimtar që i njëjti, atë shumë të parave ta vënte në qarkullimin juridik në Kosovë si para të vërteta.

Në këtë çështje penale nuk ka qenë kontestuese, se parat në kartëmonedhë dollar, janë transportuar nga Republika e Turqisë për në Republikën e Kosovës, se transportimi është kryer nga tani i pandehuri SH.B, se shuma e parave i është dorëzuar tani të pandehurit M.B nga tani i pandehuri SH.B, dhe se i pandehuri M.B, ka qenë në dijeni se parat janë të falsifikuara, siç ka qenë në dijeni për gjithë transportin e kryer të parave, nga Republika e Turqisë për në Republikën e Kosovës.

Kontestuese në këtë çështje penale, ka qenë faktet se: transporti i shumë se parave a është bërë në bashkëpunim, ndërmjet të pandehurve M.B dhe SH.B, duke u marru vesh paraprakisht, transportin dhe qëllimin që të njëjta të vëhen në qarkullim, si para të vërteta, pra a e ka ditur i pandehuri SH.B, se parat janë të falsifikuara dhe se qëllimi transportimit të tyre për në Republikën e Kosovës është vënia e tyre në qarkullim dhe se a ka qenë ky qëllimi i sjelljes së kësaj shume të parave në Kosovë.

Vërtetimi i këtyre rrethanave e ndriçon në tanësinë e saj këtë çështje penale, prandaj gjykata në përpjekje që të gjejë të vërtetën material dhe bazuar në parimin e një gjykimi të drejtë, pas analizimit dhe vlerësimit të provave të administruara në këtë drejtim, ka nxjerrë këto përfundime: I akuzuari M.B, e ka pohuar faktin e organizimit të transportimit të parave të falsifikuara si një nga format e kryerjes së kësaj vepre penale, pra se parat të cilat ja ka dhënë të pandehurit SH.B

kanë qenë të falsifikuara, mirëpo që ka mohuar se qëllimi ka qenë vënija e tyre në qarkullim, mirëpo është e qartë që nisur nga vetë arsyeja e falsifikimit të parave për tu përdorur si të vërteta dhe shuma e tyre, pra shuma e cila i është sekuestruar tani të pandehurit M.B, qëllimi përfundimtar ka qenë vënie e tyre në treg, duke i paraqitur si para të vërteta, përderisa që vetë i akuzuari M.B nuk ka dhënë kurrfarë arsye se pse është sjell kjo shumë e parave të falsifikuara në Kosovë, nëse jo për tu venë në treg si të vërteta, pra nëse jo për realizuar qëllimi pse të njëjtat falsifikohen. Në këto rrethana, qëllimi për vënjen e tyre në qarkullim si para të vërteta, është vërtetuar përfundimisht.

Sa i përket faktit nëse i pandehuri SH.B, ka vepruar në bashkëpunim më të pandehurin M.B, pra edhe ka qenë në dijeni se parat të cilat i ka transportuar kanë qenë në falsifikuara, gjykata rithekëson faktin e referuar më lart, se i njëjti e ka pranuar se ka bërë transportimin e parave sipas kërkesë së të akuzuarit M.B, ndërkaq që nuk e ka ditur se ato para janë të falsifikuara, mirëpo janë rrethana të vërtetuar nga të cila rezulton dijeni dhe bashkëpunimi i ta pandehurit SH.B, me të pandehurin M.B, dhe at nisur nga veprimet e të akuzuarit SH.B, tanimë të vërtetuar por edhe të pranuar e pohuar nga vetë i akuzuari SH.B, përfshirë mos deklarinimin e këtyre parave në pikat kufitare në të cilat ka kaluar gjatë udhëtimit për në Republikën e Kosovës, pastaj mënyra e dorëzimit, dhe vendi ku kanë qenë të vendosura parat, që për shumën e tyre, pra në një qese të zezë, është jo vetëm jo e pritshme por edhe çuditshme, rezulton qartë, se i pandehuri SH.B jo vetëm ka qenë në dijeni, mirëpo transporti i parave të falsifikuara është kryer, pas planifikimit paraprak, dhe në koordinim të plotë më të akuzuarit M.B, meqenëse duke pasur parasysh punën që ka bërë, si vozitës i autobusëve, ja ka mundur dhe lehtësuar, kryerjen e këtyre veprimeve inkriminuese në një mënyrë me të lehtë dhe se detyra e tij ka qenë pikërisht transporti deri në Republikën e Kosovës, ndërsa që hedhja e tyre në qarkullim do bëhej, nga i pandehuri M.B. Në këtë drejtim, duke gjykuar veprimet e të pandehurve, M.B dhe SH.B, në sigurimin e tyre nga i pandehuri dhe transportimin e tyre për në Republikën e Kosovës, të njëjtit kanë vepruar në bashkëkryerës, meqenëse që të dy kanë marr pjesë aktivisht në kryerjen e veprës penale.

Gjykata ka refuzuar propozimin e prokurores të çështjes që të kërkohet informacion nga pikat doganore të shteteve përkatëse në Bullgari dhe Maqedoni, nëse janë deklaruar të hollat e lartcekura nga i akuzuari SH.B, pasi që edhe vetë i akuzuari SH.B, ka deklaruar që në pikat kufitare nuk është përpiluar asnjë dokumentacion nga oficerët doganorë dhe se nuk ka dokumentacion, pra thënë ndryshe se gjatë kalimit nëpër këto pika kufitare parat nuk i ka deklaruar fare. Andaj, në këto kushte, nuk është e nevojshme të mirren e administrohen provat, lidhur me eksistimin apo moseksistimin e rrethanave të cilat i pohn pala përkatësisht në këtë rast vetë i akuzuari, i cili thotë se nuk është përpiluar dokumentacion.

Mbrojtja e të akuzuarve

I akuzuari M.B, e ka pranuar fajësinë në shqyrtim gjyqësor, mirëpo që një pranim i tillë, nuk është aprovuar, ndërsa që në mbrojtjen e paraqitur gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, ka mohuar faktin se transportimi i parave të falsifikuara është vërë me qëllim të vënies së tyre në treg, mirëpo që nuk ka arritur të tregoj dhe shpjegoj arsyen e transportimit të tyre për në Kosovë, duke pasur parasysh se falsifikimi i parave bëhet pikërisht që në vënie në qarkullim, duke i paraqitur si të vërteta, për më tepër duke marr parasysh shumën e parave, për të cilat siç u tha nuk ka dhënë jo vetëm një shpjegim racional e të besueshme por nuk ka dhënë shpjegim fare, se përçfar arsye tjetër ka mundur të i përdor të njëjtat.

Sa i përket të akuzuarit SH.B, në mbrojtjen e paraqitur është pretenduar se i njëjti nuk e ka ditur që parat e transportuara janë të falsifikuara, mirëpo që ky pretendim është i pabazuar, duke pasur

parasysh faktin se i akuzuari SH.B, fillimisht nuk ka dhënë një shpjegim të arsyeshëm dhe të besueshëm për mënyrën se si është kontaktuar nga i akuzuari M.B lidhur me bartjen e shumës së parave, duke pretenduar se ka mjaftuar një telefonat nga i akuzuari M.B dhe me këtë ka pranuar që të bartë shumën e parave, duke mos ngritur dyshim fare nëse të njëjta janë të falsifikuara apo ka ndonjë problem tjetër që të njëjtat nuk transferohen përmes transaksionit bankar, mënyrë e zakonshme e transferimit të parave, sidomos në shuma të tilla, pastaj, mos deklarimi i tyre në asnjëherë nga pikat kufitare, fillimisht duke pretenduar se i ka deklaruar, dhe atë duke i deklaruar të njëjta në pronë të katër personave që kanë qenë në autobus, njëherit familjar të njëjtit, pastaj, se këta persona nuk e kanë ditur që është duke i transportuar këto para, pastaj se deklarimi është bërë në emër të tyre, por padijeninë e tyre, ndërsa që arsyeja e mos deklarimit gjatë hyrjes në pikën kufitare në Kosovë, është se ka qenë duke fjetur, se në rast tjetër do të deklaronte, mirëpo pas propozimit të paraqitur nga prokurorja e çështjes që të sigurohet dokumentacioni e deklarimit nga shtetet e Bullgarisë dhe Maqedonisë, i akuzuari për mes mbrojtëses së tij, ka pohuar faktin se kinse me rastin e deklarimit nuk është përpiluar dokumentacion, anipse në të gjitha rastet, të gjitha sendet e deklaruara evidentohen në regjistrat përkatës, e aq më shumë, duke pasur parasysh shumën e parave, që pretendon se e ka deklaruar. Pra të gjitha këto pohime të pa qenë, janë në funksion të mohimit të ekzistimit të rrethanave se tani më të vërtetuar qartë dhe plotësisht se si i pandehuri SH.B, jo vetëm e ka ditur se parat janë të falsifikuara, mirëpo edhe i gjithë transportimi tyre është kryer në bashkëpunim me të pandehurin M.B dhe se qëllimi i tyre ka qenë vënia e tyre në qarkullim si para të vërteta. Mbrojtja, mjaftohet dhe ju referohet vlerësimeve të personave tjerë, përfshirë edhe bashkë të akuzuarit M.B, sipas të cilëve i akuzuari SH.B nuk e ka ditur se është duke transportuar para të falsifikuara dhe se i njëjti është njeri i mirë, mirëpo të gjitha këto nuk janë prova, dhe as që vën mos besueshmëri mbi provat e paraqitura nga organi i akuzës, meqenëse, të gjykuarit i mirë apo i keq, është çështje morale, e cila studiohet nga etika si shkencë mbi moralin, dhe është në të drejtën e gjithsecilit të ketë vlerësimin e caktuar për cilindo, ndërsa që të qeni i fajshëm është koncept ligjor, që mund të vërtetohet vetëm prova konkrete, përmes të cilave krijohet bindja e plotë, mbi ekzistimin e tij.

Me rastin e vlerësimit të rrethanave të cilat ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, për të pandehurit në kuptim të nenit 69 të KPPRK-ës, gjykata për të pandehurin M.B ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese, faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë, përkatësisht ka qenë bashkëpunues me organet e ndjekjes, duke i pohuar veprimet inkrimuese të tij, që në fazën fillestare të hetimeve në këtë çështje penale, pas si rrethanë lehtësues për këtë të pandehur dhe të pandehurin SH.B ka gjetur dëmin jo të konsiderueshme të shkaktuar me këtë veprë penale, meqenëse parat është arritur të konfiskohen derisa të njëjta nuk janë hedhur në treg, faktin se gjykata nuk ka të dhëna se të njëjti me herët janë gjykuar apo dënuar për vepra të kësaj apo të ndonjë natyre tjetër në Republikën e Kosovës, të njëjtit janë familjar dhe mbajtës të familjeve të tyre, ndërsa që sa i përket rrethanave rëndësues, gjykata të tilla ka gjetur natyre e kësaj veprë penale, dhe rreziku dhe dëmi që do të shkaktohej për sistemin financiar, për sistemin e pagesave dhe për veprimtarinë ekonomike. Andaj, bazuar në këto rrethana gjykata ua ka shqiptuar dënimet me burgim, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimet ie shqiptuara janë në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve, intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, dhe në këtë mënyrë do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëjë rehabilitimin e të njëjtëve, si dhe do të ndikojë në vetëdijësimin dhe përmbajtjen e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, çka është edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar për të akuzuarit, është marrë konform nenit 79 par.1 të KPRK-së, derisa të akuzuarve me aktvendim të veçantë, i është vazhduar paraburgimi, i cili mund të zgjasë deri në plotëfuqishmëri e këtij aktgjykimi, por jo më

shumë se koha e dënimit të shqiptuar në aktgjykim, konform nenit 367 par.1, nen par 1.1 të KPPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlikueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale, si dhe gjendjen pasurore e të pandehurve, konform nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së, ndërsa vendimi për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit është marr sipas Ligjit nr. 05/L-036, për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për konfiskim parave-kartëmonedhave të falsifikuara është marr bazuar në nenin 296.par.6 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti Special
PS.nr.1 /22 datë 17.06.2022,

Bashkëpunëtori profesional
Driton Berisha

Kryetarja e trupit gjykues– gjyqtarja
Violeta Namani-Hajra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.